



HERITAGE
SPACE VI

UDHËZIME
PËR APLIKIM

HERITAGE SPACE VI

Përshkrim i shkurtër i Heritage Space

Heritage Space u inicua në vitin 2016 nga CHwB Kosova, për të inkurajuar artistë, studiues dhe profesionistë të tjerë që veprojnë në fushën e kulturës, industrisë kreative dhe shkencave humanistike digjitale, që të punojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore përmes hulumtimit dhe dokumentimit. Nëpërmjet mentorimit profesional dhe mbështetjes teknike, kjo platformë nxit qasje të reja në trajtimin e trashëgimisë kulturore, me qëllim të krijimit të bisedave kuptimplota mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Qëllimet afatgjata të platformës sonë:

- Komisionim dhe mbështetje për krijim të veprave të reja të artit;
- Ndërlidhja e trashëgimisë kulturore me artin dhe praktikën tjera kulturore;
- Shqyrtimi i mënyrave të reja dhe kreative për ruajtjen, promovimin dhe rijetësimin e trashëgimisë kulturore;
- Rrjetëzimi mes sektorëve dhe fushave të ndryshme kulturore;
- Vetëdijësimi i qytetarëve mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore si themel i zhvillimit kulturor, shoqëror dhe ekonomik;
- Punësimi i të rinjve në sektorin e kulturës.

Heritage Space VI do t'i mbështesë temat e mëposhtme:

Arkivimi i Shkëputjeve

Dokumentet e shpërndara, dyert e mbyllura dhe amnezia institucionale bëhen shkas për t'i vënë në pyetje praktikën arkivore apo mungesën e tyre. Arkivat janë struktura të kujtesës kolektive dhe vazhdimësisë historike. Roli i institucioneve është që në mënyrë aktive të mbledhin, ruajnë dhe t'i bëjnë të materialet arkivore të qasshme për publikun. Atëherë, si të merremi me mungesën dhe anshmërinë e arkivave të tranzicionit? A mund t'i ri-gjejmë historitë e humbura përmes arkivave ekzistuese në Kosovë? Si mund të regjistrohen materialet e përkohshme dhe të krijohen arkivat e kujtesës kolektive? A do të na ndihmonin qasjet eksperimentale në propozimin e një narrative alternative ndaj dëshmive të humbura historike?

Ftojme propozime që kanë për qëllim shqyrtimin e arkivave dhe aktivizimin e tyre për të ofruar mënyra të reja të menduarit mbi të kaluarën dhe të tashmen, duke hedhur dritë mbi histori të ndryshme lokale të panjohura ose të harruara. Projektet mund të përfshijnë hulumtime mbi formimin historik të institucioneve, si për shembull lindja dhe vdekja e institucioneve kulturore, historitë sociale të fabrikave, organizatat e pakicave kombëtare dhe platformat feministe. Gjithashtu, inkurajojmë hulumtime që trajtojnë arkivat e opozitës, apo 'kundër-arkivat', siç mund të jenë platformat alternative të të mësuarit, grevat e punëtorëve dhe lëvizjet subkulturore dhe 'underground', si dhe metodologjitë alternative të hulumtimit (shembull: taktikat queer ose strategjitë feministe) të cilat janë zhvilluar si përgjigje ndaj mungesës së qasjes në arkiva ose përjashtimit nga të dhënat historike.

HERITAGE SPACE VI

Trashëgimia e Krizave

Shumica e shoqërive bashkëkohore jetojnë me plagë të historisë që nxisin apo janë rezultat i luftërave, trazirave civile, dhunës sistematike shoqërore dhe diskriminimit. Këto periudha krizash prodhojnë pasoja shoqërore, psikologjike dhe historike që mund të gjurmohen në një sërë ngjarjesh, hapësirash apo praktikash të cilat, në kontekstin tonë mund të përfshijnë vende dhe praktika të rezistencës, protestës, dhe manifestimeve të tjera të mosbindjes civile.

Trashëgimia e Krizave mund të gjendet edhe në vende dhe ndodhi konkrete që ndërliken me kujtime të atrociteteve, siç janë masakrat dhe ekzekutimet, dhuna seksuale përgjatë luftës, shtigjet e shpërnguljeve, vendndodhjet e zhdukjeve, humbjet materiale dhe jo-materiale, vendet që lidhen me të burgosurit e luftës dhe burgjet civile apo politike. Inkurajojmë metodologji që synojnë të shënojnë, përkujtojnë, ruajnë dhe dokumentojnë, individualisht apo institucionalisht, tregimet, kujtimet dhe vendet e lartpërmendura, për të mundësuar perspektiva të reja në praktikën e hulumtimit, interpretimit dhe dokumentimit.

Rrëfim dhe Interpretim

Të vendosura së bashku, Rrëfimi dhe Interpretimi luajnë rol të rëndësishëm në ndryshimin e mënyrës se si i qasemi, përfshijmë dhe komunikojmë trashëgiminë kulturore. Më shumë se në detaje faktike, Rrëfimi dhe Interpretimi fokusohen në njerëz, në të kaluarën dhe në lidhjen me vendin. Në këtë mënyrë, mundësohet shpalosja e tregimeve njerëzore që qëndrojnë prapa trashëgimisë së përbashkët.

Rrëfimi dhe Interpretimi mund të përfshijnë: histori individuale, kolektive dhe kombëtare, të ruajtura dhe rrëfyera si tregime, narrativa të bazuara në fakte të hulumtuara mirë, njohuri lokale dhe thashetheme, përralla, mite, legjenda, fjalëgoje, këngë, tregime vizuale, trillime të bazuara në të vërteta, të cilat në përgjithësi, përmes medimeve të ndryshme, shpalosin perspektiva që kanë për qëllim të argëtojnë, edukojnë, ruajnë dhe pasurojnë kulturën tonë të përbashkët.

Çfarë do të ofrojë Heritage Space VI?

Heritage Space do të:

- Ofrojë mentorim, konsultime dhe ekspertizë nga tre mentorët e përzgjedhur, të cilët do të ndihmojnë gjatë zhvillimit dhe prezantimit përfundimtar të projekteve të përzgjedhura;
- Asistojë në krijimin e një rrjeti të individëve dhe institucioneve të ndryshme të domosdoshme për zhvillimin e suksesshëm të projekteve të përzgjedhura;
- Ofrojë mbështetje financiare për palët e angazhuara në projekt. Shuma mesatare e grantit është 6,000 euro, ndërsa shuma maksimale e grantit nuk mund të tejkalojë vlerën prej 10.000 euro. Për prezentimin publik të projekteve përfundimtare do të ofrohet financim shtesë;
- Ofrojë mbështetje në promovimin e projekteve të përzgjedhura përgjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe finalizimit të tyre;
- Organizojë prezantime publike për projektet e përzgjedhura. Për prezantime

HERITAGE SPACE VI

publike do të merren parasysh vetëm ato projekte të cilat përgjatë zhvillimit të tyre përcjellin standardet e implementimit që përcaktohen nga marrëveshja kontraktuale mes përfituesit dhe platformës Heritage Space;

- Sigurojë dokumentim vizuel të të gjitha prezantimeve publike;
- Përfshijë projektet finale në publikimin vjetor të Heritage Space i cili ka për qëllim të prodhojë diskurse të reja dhe përmbledhë perspektiva shtesë lidhur me projektet dhe temat e edicionit.

Procesi i mentorimit

Në çdo edicion, platforma Heritage Space zgjedh një grup të mentorëve të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre për t'i mbështetur përfituesit përgjatë të gjitha fazave që nga zhvillimi deri tek finalizimi i projekteve. Mentori/ja është dikush që ofron këshillim, informacion dhe njohuri nga përvoja e tyre, në adresimin e çështjeve dhe mundësive që lindin përgjatë implementimit të secilit projekt. Pasi të përzgjedhen përfituesit e Heritage Space VI, do të caktohen seanca të mentorimit përgjatë procesit të implementimit, gjithnjë duke u bazuar në nevojat specifike të secilit projekt. Varësisht nga nevojat e projekteve, secilit përfitues do t'i ndahen deri në 40 orë, gjegjësisht 5 ditë pune, të seancave individuale me mentorët e tyre përkatës gjatë gjashtë muajve të implementimit.

Një proces i suksesshëm mentorimi kërkon që të gjitha palët e përfshira të luajnë rol aktiv në vendosjen dhe mbajtjen e një dialogu pozitiv, konstruktiv dhe të respektueshëm. Mentorët tanë do të ofrojnë mbështetje nëpërmjet komenteve të sinqerta në lidhje me konceptin dhe nevojat teknike të një projekti, si dhe seanca mentorimi të planifikuara me kujdes që kanë parasysh caktimin e qëllimeve të realizueshme, hulumtimet e duhura, qasje në informacion, të dhëna të rëndësishme dhe rrjetëzim me individë apo institucione relevante të domosdoshme për zhvillimin e projektit. Përveç kësaj, mentorët do të ofrojnë këshilla për promovimin, shpërndarjen si dhe strategjinë e komunikimit të projekteve finale. Përfituesit e Heritage Space inkurajohen të luajnë një rol aktiv duke marrë përgjegjësi mbi procesin, duke reflektuar rregullisht mbi nevojat e projektit dhe duke i komunikuar ato gjatë seancave individuale. Për të përfituar sa më shumë nga platforma Heritage Space, ne presim që përfituesit tanë të jenë të hapur ndaj sfidave, të jenë të shkathët në caktimin e qëllimeve dhe të veprojnë mbi to.

Mentorët/et e Heritage Space VI

Doruntina Basha/ dramaturge dhe skenariste

Sezgin Boynik/ hulumtues dhe redaktor

Arnisa Zeqo/ kuratore, shkrimtare dhe pedagoge

Klikoni [këtu](#) për më shumë informata rreth mentorëve tanë.

HERITAGE SPACE VI

Kush mund të aplikojë?

- Të gjithë banorët e Kosovës, mbi moshën 21 vjeçare, pavarësisht nga përkatësia e tyre gjinore, etnike ose tjetër. Aplikantët të cilët nuk e posedojnë shtetësinë e Kosovës duhet ta aneksojnë dëshminë e vendbanimit;
- Individët, idetë e të cilëve bazohen në mundësitë e reja që ofrohen nga arti dhe kultura, industritë kreative dhe në veçanti nga trashëgimia kulturore;
- Ata/ato që kanë njohuri elementare si për trashëgiminë kulturore njashtu për fushën apo temën kreative përkatëse;
- Artistë vizuel, hulumtues, performues, kuratorë, dizajnerë grafik, kineastë, shkrimtarë, historianë, antropologë, fotografë, zejtare dhe çdokush tjetër praktika e të cilit/ës përkon me kriteret e aplikimit;
- Më së shumti dy individë mund të aplikojnë me një ide të projektit.

*Statusi i karrierës nuk është prioritet, meqenëse ne besojmë se idetë mund të jenë të mrekullueshme pavarësisht përvojës profesionale apo akademike.

*Aplikacionet pranohen në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

*Para dorëzimit, ju rekomandojmë që t'i kushtoni kohë të mjaftueshme aplikimit. Mos i kufizoni idetë e juaja vetëm në trashëgiminë e prekshme (ndërtesa apo objekte). Trashëgimia kulturore përfshinë edhe shumë aspekte tjera të jetës shoqërore.

Çka nuk mbështesim:

- Projekte të cilat nuk janë të ndërlidhura me artin dhe kulturën, industritë kreative ose nuk që ndërthuren me trashëgiminë kulturore lokale;
- Projektet e propozuara nga subjektet tjera siç janë organizatat/kompanitë/OJQ-të;
- Idetë të cilat e kanë kaluar fazën e konceptimit dhe zhvillimit dhe tashmë janë duke u implementuar, ose projekte që tashmë kanë gjetur mbështetje nga organizata të tjera. Qëllimi i Heritage Space është të ofrojë mbështetje për zhvillim gjatë periudhës së implementimit, andaj projektet që janë në fazën përfundimtare konsiderohen si të pakualifikueshme;
- Idetë që kanë të bëjnë me konzervimin e trashëgimisë së ndërtuar, rijetësim (adaptive reuse) dhe me gërmimet arkeologjike;
- Aplikantët që janë përzgjedhur si përfitues të edicioneve të mëparshme të Heritage Space. Megjithatë, nëse keni qenë të përfshirë në ndonjë projekt të mëparshëm të Heritage Space, por vetëm si bashkëpunëtor, në atë rast ju keni të drejtë aplikimi.

Implementimi i projekteve

HERITAGE SPACE VI

- Periudha e implementimit të projekteve të mbështetura do të fillojë nga muaji shkurt i vitit 2022 dhe do të përfundojë në korrik të 2022;
- Të gjitha projektet duhet të jenë të gatshme për prezantime publike deri në gusht dhe shtator të vitit 2022;
- Drejtuesit e projekteve duhet të raportojnë mbi mbarëvajtjen e projektit në baza mujore;
- Drejtuesit e projekteve do të bashkëpunojnë me ekipin e Heritage Space gjatë proceseve të përgatitjes dhe implementimit të prezantimeve publike.
- Përfituesit duhet të jenë të hapur për t'i diskutuar fazat e zhvillimit të projektit me mentorët e tyre.
- Secili përfitues mund të punojë me më shumë se një mentor;
- Të gjitha pagesat duhet të procesohen deri më 15 korrik 2022.
- Lejohet mbledhja e fondeve shtesë, por vetëm sipas specifikimeve të kontratës së nënshkruar midis përfituesit dhe menaxherit të projektit të Heritage Space.

Kufizimet e mundshme

Platforma Heritage Space është e vetëdijshme se mund të ketë ndërlikime për shkak të pandemisë. Implementimi i disa aktiviteteve mund të ndryshojë ose të shtyhet. Megjithatë, ekipi ynë do të ketë konsideratë për çfarëdo kufizimi potencial në të ardhmen, duke mundësuar që implementimi të përshtatet në përputhje me rrethanat e reja në marrëveshje të përbashkët me përfituesit.

Shpenzimet që nuk mund të përfshihen në tabelën e buxhetit:

- Shpenzimet e prezantimit publik;
- Shpenzimet e projekteve të tjera ekzistuese, qoftë personale apo profesionale;
- Blerja e materialeve dhe pajisjeve si: laptopët, kamerat, audio pajisjet, telefonët mobil, etj;
- Pagesa e borxheve personale apo shërbimeve komunale;
- Shpenzime që nuk lidhen drejtpërdrejtë me përmbajtjen dhe objektivat e projektit të propozuar.

*Përveç shpenzimeve të projektit, ju sugjerojmë që ta caktoni një honorar tuajin për udhëheqje të projektit për periudhën gjatë të cilës do të jeni të angazhuar në projekt.

Procesi i vlerësimit

HERITAGE SPACE VI

Faza 1 (11 - 15 janar 2022): Të gjitha aplikacionet e dorëzuara shqyrtohen nga ekipi i Heritage Space për t'u siguruar që janë në përputhje me kriteret për kualifikim dhe nëse janë të kompletuara. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të vlerësohen nga Komisioni i Përzgjedhjes në fazën e dytë.

Faza 2 (17 - 27 janar 2022): Të gjitha aplikacionet që kualifikohen në përputhje me dokumentet e kërkuara kalojnë në fazën e vlerësimit. Anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes do të lajmërohen në ueb faqen e CHwB Kosova, pas mbylljes zyrtare të thirrjes së hapur. Komisioni i Përzgjedhjes zotëron profesionalizëm dhe ekspertizë në temat e adresuara në këtë edicion të Heritage Space. Gjatë kësaj faze, Komisioni i Përzgjedhjes do të bëjë përzgjedhjen e aplikantëve të cilët do të ftohen për intervista që zhvillohen në fazën e tretë. Aplikantët të cilët nuk e kalojnë fazën e dytë dhe që nuk janë përzgjedhur për intervista do të njoftohen përmes emailit.

Faza 3 (27 janar - 14 shkurt 2022): Aplikantët që do ta kalojnë fazën e dytë të vlerësimit do të ftohen për të paraqitur konceptin e tyre në një intervistë para Komisionit të Përzgjedhjes. Secila intervistë do të zgjasë më së shumti 30 minuta. Aplikantët që shprehin dëshirën, mund të prezantojnë materiale dhe detaje plotësuese në lidhje me projektin e propozuar. Aplikantëve të cilët me sukses e kalojnë intervistën do t'u kërkohet finalizimi i planit të veprimit si dhe buxheti i rishikuar, në rast se ka modifikime të propozuara nga Komisioni i Përzgjedhjes. Kontrata do të nënshkruhet jo më larg se 20 shkurt 2022.

Kriteret e vlerësimit

Komisioni i Përzgjedhjes vepron sipas vlerave të platformës Heritage Space sa i përket diverzitetit, transparencës dhe gjithëpërfshirjes. Komisioni do t'i vlerësojë aplikacionet në mënyrë të paanshme konform vlerave dhe parimeve të platformës Heritage Space.

Vlerësimi i aplikacioneve bëhet në bazë të informacionit të ofruar në dokumentet e dorëzuara dhe vlerësohet sipas kriterëve të mëposhtme:

- Cilësia: Cilësia e idesë, propozimit të metodës, materialeve dhe teknikave që do të aplikohen.
- Kreativiteti: Vlera kreative dhe inovative e idesë së propozuar.
- Përshtatshmëria: Niveli në të cilin ideja përkon me objektivat e Heritage Space – mënyra se si kjo ide trajton trashëgiminë kulturore, historinë, artin dhe ndërdisiplinartë.
- Saktësia: Prezantimi dhe përshkrimi i kuartë i aktivitetit/idesë.
- Qendrueshmëria: Ideja do të mund të vazhdojë të zhvillohet në mënyrë të pavarur edhe pasi të jetë finalizuar, dhe rëndësia e saj nuk kushtëzohet në afate kohore.
- Buxheti: Buxheti i projektit është i arsyeshëm dhe mbulon të gjitha mjetet

HERITAGE SPACE VI

financiare të domosdoshme për jetësimin e idesë.

- Menaxhimi i kohës: Projekti duhet të finalizohet brenda pesë muajve. Përparësi do të kenë propozimet që më së miri planifikojnë mënyrën e organizimit të kohës së tyre.
- Strategjia e prezantimit dhe komunikimit: Mënyra se si aplikantët planifikojnë të prezantojnë apo komunikojnë rezultatin final të projektit, si do t'i qasen publikut të gjërë apo si të gjejnë audiencën për projektin e tyre.
- Njohuritë paraprake: Aplikanti duhet të zotërojë njohuri elementare si mbi trashëgiminë kulturore ashtu edhe rreth mediumit apo disiplinës me të cilën aplikon. Nevojitet më shumë njohuri lidhur me temën specifike të zgjedhur për aplikim.
- Menaxhimi i rrezikut: Aplikanti duhet të zotërojë njohuri elementare si mbi trashëgiminë kulturore, ashtu edhe rreth mediumit apo disiplinës me të cilën aplikon. Nevojitet më shumë njohuri lidhur me temën specifike të zgjedhur për aplikim.
- Mundësia e Qasjes: Puna përfundimtare të jetë e qasshme për publikun përgjatë një periudhe afatgjate.

Si financohet Heritage Space?

Projekti Heritage Space implementohet nga CHwB Kosova. Aktiviteti i projektit financohet nga Qeveria Suedeze dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë.

CHwB Kosova është pjesë e ILUCIDARE – një rrjet ndërkombëtar që do të ofrojë mbështetje dhe promovim për të gjithë përfituesit e mbështetur nga platforma Heritage Space.

Dokumentet e nevojshme dhe afati për aplikim:

Në mënyrë që aplikimi juaj të merret në konsideratë, nevojiten:

- Formulari për aplikim i plotësuar;
- CV (portofolio, nëse keni);
- Letërnjoftimi juaj (i skanuar);
- Leje-qëndrimi (për jo-shtetasit e Kosovës);
- Në e-mailin e aplikimit mund të bashkëngjitet çfarëdo dokumenti shtesë që ka të bëjë me projektin, p.sh video, audio, skica, publikime apo ndonjë dokument tjetër që mund të jetë i dobishëm në procesin e përzgjedhjes, mirëpo duhet të siguroheni që materialet shtesë nuk i tejkalojnë 20 MB. Ju lutemi të plotësoni tërësisht formularin për aplikim në kompjuter.

HERITAGE SPACE VI

Formulari për aplikim, së bashku me dokumentet e kërkuara duhen të dërgohen para **10 janar 2022 (në ora 23:59)**, në email-in: **chwb.kosovo@gmail.com**. Me rastin e dërgimit të aplikacionit përmes email-it, ju lutemi që tek subjekti i email-it të shkruani: **“Aplikimi për Heritage Space 2022 (emri dhe mbiemri)”**.

Keni pyetje?

Nëse ju nevojiten informata shtesë rreth Heritage Space dhe procesit të aplikimit, ju ftojmë të merrni pjesë në seancën tonë informative online, e cila do të mbahet gjatë muajit dhjetor 2021. Për ta shfrytëzuar këtë mundësi ju lutemi ndiqni mediet dhe rrjetet tona sociale për informata më të detajuara.

Për çdo informacion shtesë, ju lutem ta ndiqni faqen tonë në Facebook, CHwB Kosova, si dhe ta vizitoni faqen tonë të internetit **www.chwb.org/kosovo**, ose na kontaktoni në **chwb.kosovo@gmail.com** para **10 janarit 2022**.

Ju lutemi të keni parasysh që në pyetjet e juaja përgjigjemi vetëm përmes email-it.